



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR
PËR EKONOMINË DHE FINANCAT**

Dokument Parlamentar

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 23.04.2019

**RAPORT
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË
PËR VITIN 2018**

Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjen e datës 23 Prill 2019, mori në shqyrtim raportimin vjetor të punës së Bankës së Shqipërisë për vitin 2018.

Komisioni, bazuar në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi çështjen në përputhje me rendin e ditës dhe kalendarin e punimeve të tij.

Nga relatorja zonja Evis KUSHI, u lexuar një raport i përmbledhur dhe teksti i draft rezolutës që i propozohet Komisionit për miratim.

Në vijim ju dha fjala Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë Zotit Gent SEJKO, i cili bëri një përmbledhje dhe prezantim të punës dhe veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2018.

Më pas deputetët i bënë pyetje dhe parashtruan edhe çështje të një rëndësie të veçantë e të lidhura me funksionet e Bankës së Shqipërisë.

Në fund, Kryetari i Komisionit zoti Arben AHMETAJ bëri një përmbledhje dhe referoi në shtesat që i duhen bërë rezolutës në reflektim të diskutimeve dhe çështjeve që u evidentuan nga pyetjet e bëra nga deputetët.

Në përfundim është përgatitur Draft-Rezoluta bashkëlidhur, e cila reflekton problematikat e nxjerra nga Komisioni gjatë seancës së raportimit vjetor të BSH, çështjet e trajtuara nga relatorja, çështjet e trajtuara nga Kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave si dhe ato të evidentuara nga Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit.

- **Në përfundim**, Komisioni mbështetur në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, miratoi projektrezolutën bashkëlidhur këtij raporti, të cilën ia paraqet për miratim Kuvendit.

Relator
Evis (KUSHI) CAKU

KRYETAR
Arben AHMETAJ